

L I G J
Nr.7887, datë 8.12.1994

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.938, DATË 11.10.1994 “PËR
DETYRIMIN SHKOLLOR”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet dekreti nr.938, datë 11.10.1994 “Për detyrimin shkollor” me ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 1, paragrafi i fundit ndryshohet “Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja”.
2. Në nenin 2, në fund të paragrafit të dytë hiqen fjalët “vendimi i së cilës është i formës së prerë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.994, datë 22.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha